



BASHKIA LEZHË

MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISË

Z. PJERIN NDREU



RISHIKIM I PLANIT TE DETYRUAR VENDOR (PDyV) PËR
ZONËN E RE TË ZHVILLIMIT 2, NJËSIA ADMINISTRATIVE
LEZHË, BASHKIA LEZHË

Mars 2021

RISHIKIM I PLANIT TË DETYRUAR
VENDOR (PD_yV) PËR ZONËN E RE
TË ZHVILLIMIT 2, NJËSIA
ADMINISTRATIVE LEZHË, BASHKIA
LEZHË

Mars 2021

1. Hyrje

Pas tërmetit të datës 26 nëntor 2019, Qeveria Shqiptare mori nismën për të mbështetur bashkitë e prekura, përmes një plani për rindërtim dhe mëkëmbje sociale.

Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", parashikon strukturimin e procesit të rindërtimit nga planifikimi i territorit përmes Planit të Detyruar Vendor (PDyV); një instrument që hartohet për një zonë të veçantë, të shpallur me vendim të Këshillit të Ministrave, si Zonë e Re për Zhvillim (ZRZh), e cila mund të jetë një zonë e dëmtuar, ose një territor i lirë nga ndërtimet, apo i përshtatshëm për procesin e rindërtimit.

Qeveria shqiptare ka caktuar, nga Fondi i Rindërtimit, një fond të posaçëm për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore dhe ka ngarkuar Agjencinë e Planifikimit të Territorit si njësi zbatuese për hartimin e PDyV-ve, mbi bazën e VKM nr.9, datë 10.01.2020, "Për caktimin e njësive zbatuese për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore dhe financimin e tyre nga Fondi për Rindërtimin miratuar në Buxhetin e vitit 2020".

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, më datë 07 Shkurt, të vitit 2020, miratoi propozimin për caktimin e Zonave 1 dhe 2, përkatësisht 3.5 ha dhe 9.5 ha, në Njësinë Administrative Lezhë, Bashkia Lezhë si Zonë e Re për Zhvillim. Në vijim të tekstit zonave do t'u referohemi me akronimet :ZRZh_LE_1 dhe ZRZh_LE_2



Figura 1. ZRZh_LE_2 – gjendja aktuale-kufi i zonës

2. ARSYET E RISHIKIMIT TË PDyV ZRZh “2 Lezha”

Pas përfundimit të Akt –ekspertizave nga Instituti i Ndertimit dhe Analizave të thelluara përkatëse për godinat e demtuara nga termeti i dates 26.11.2019, lista e objekteve të demtuara te propozuara per shembje dhe rindertim ka pesuar ndryshime, mbeshtetur në përfundimet e akt-ekspertizave të thelluara. Për sa më sipër Bashkia Lezhe, ka paraqitur kërkesen për ndryshime në nevojën për strehim drejtuar Komisionit Shtetëror të Rindertimit me shkresën Nr.21695 Prot. date 04.12.2020, sipas detajimit të mëposhtëm:

Nevojat për njësi akomoduese në Zona 2, Zonën e Re për Zhvillim, bashkia Lezhë, bëhen

- 24 Apartamente 1+1
- 40 Apartamente 2+1
- 16 Apartamente 3+1

Ky ndryshim i propozuar është miratuar me vendimin Nr.64 date 07.12.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindertimit, vendim i cili ngarkon Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Bashkinë Lezhë, për rishikimin e PDyV në ZRZH “2 Lezha”.

3. OBJEKTI I RISHIKIMIT TË PDyV ZRZh “2 Lezha”

Bazuar në vendimin Nr.64 date 07.12.2020 të Komisionit Shtetëror të Rindertimit, vendim i cili ngarkon Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Bashkinë Lezhë, për rishikimin e PDyV në ZRZH “2 Lezha”, është bërë rishikimi i hartës së planifikimit urban dhe konkretisht është bërë një rishikim i objekteve O-5 dhe O-6 të propozuar nga PDyV, duke e vendosur në gjurmën e objektit ekzistues të klasifikuar për shembje në baze të akt-ekspertizave. si dhe rishikimi i treguesve të zhvillimit për këto objekte.



Figura 2. Fragment nga Harta e Përdorimit të Tokës ZRZh_LE_2 – PDyV “2 Lezha”

HARTOI
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN
Ing. Alban LAÇI